



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e mbajtur me 31. 10. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës miratoj këtë:

**V E N D I M**  
**PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE**

**Neni 1**

**Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete**

Me këtë Vendim, zëvendësohet anëtari i komitetit për komunitete z. Boban Jovanovič i caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017, në numrin rendor 8 dhe në vend të tij **CAKTOHET** Slaviša Trajkovič nga Lipjani, për arsye të dorëheqjes së z. Boban Jovanovic për arsyet e tij personale të cekura në aktin e tij mbi dorëheqjen.

**Neni 2**

**Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi**

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas e publikimit në WebFaqen e Komunës.

15Nr. 020-67918

Lipjan, më 01. 11. 2018

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Daut Azemi**